



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

**MBI PROGRAMIN KOMBËTAR TË BURSIVE PËR SHKËMBIME AKADEMIKE
NË SLOVAKI, VITI AKADEMIK 2017-2018**

Qeveria e Republikës së Sllovakisë ka shpallur **Programin Kombëtar të Bursave të Republikës së Sllovakisë** (National Scholarship Program-NSP of the Slovak Republic) për shtetasit e huaj, të cilët dëshirojnë të kryejnë studime, kërkime pranë universiteteve sllovaqe, organizatave kërkimore, institucioneve të artit, etj. Ky program synon të mbështesë me bursë shkëmbimet e studentëve të huaj universitarë dhe pasuniversitarë, të doktoratës, pedagogeve të universitetit, studiuesve dhe specialistëve, etj. (me kohëzgjatje nga 1-10 muaj) për vitin akademik 2017-2018, në programet e studimit:

- Master (1-10 muaj): Të gjithë të interesuarit duhet të jenë të pajisur me një diplomë Bachelor ose të kenë kryer të paktën 2.5 vite studime universitare në një Universitet të akredituar jashtë Sllovakisë.
- Doktoratë/ Postdoktoratë (1-10 muaj);

Programi financohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Kërkimit dhe Sportit të Republikës së Sllovakisë dhe administrohet nga Agjencia Sllovaqe për Informacionin Akademik (Slovak academic Information Agency, SAIA).

Procedura e aplikimit realizohet dy herë në vit (në pranverë dhe vjeshtë). Afati i fundit i aplikimit për pranimet në pranverë 2018 është data **31 tetor 2017**, ndërsa për pranimet në vjeshtë 2018 është data **30 prill 2018**. Aplikimi realizohet online: www.scholarships.sk. Modalitetet lidhur me mbulimin e shpenzimeve përcaktohen pasi kandidatët të jenë pranuar nga universitetet përkatëse sllovaqe për ndjekjen e studimeve në bazë të kualifikimit që ata kanë.

Përzgjedhja e kandidatëve behet nga një Komision i Posaçëm i ngritur në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Kërkimit dhe Sportit të Republikës së Sllovakisë.

Kushtet për përfitimin e bursës, përshkrimin e detajuar të degëve studimore, si dhe informacione të tjera rreth programit gjenden në faqen zyrtare të internetit:

www.stipendia.sk; www.scholarships.sk
<https://www.scholarships.sk/en/main/programme-terms-and-conditions/foreign-applicants>;

Bashkëlidhur këtij njoftimi ndodhet Informacioni bazë mbi Programin Kombëtar të Bursave të Republikës së Sllovakisë.

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE